



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 1. pika (ç) të Rregullores Nr.2001/19 për Degën e Egzekutivit të Inistitucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke marrë parasysh Shtojcën VII pika (IV) të Rregullores nr.2001/19 për Degën e Ekzekutivit të Inistitucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Më qëllim që të sigurohen rregullat dhe standardet unike për prezentimin dhe paraqitjen e të miturve dhe personave me aftësi të kufizuar mentale në mjetet e informimit të cilët janë nën përkujdesjen e Inistitucioneve profesionale, Ministri i MPMS-së nxjerr këtë :

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.2/2003
PËR
PREZANTIMIN E TË MITURVE DHE PERSONAVE MË AFTËSI TË KUFIZUARA
MENTALE NË MJETET E INFORMIMIT

Neni 1

Qëllimi i udhëzimit administrativ

- 1.1** Ky udhëzim administrativ, përcakton format, kushtet dhe procedurat e prezantimit dhe eksponimit të foshjeve të braktisuara, të miturve dhe personave më aftësi të kufizuara mentale, në mjetet e informimit të cilët janë nën mbikëqyrje dhe përkujdesje të kujdestarit ligjor dhe institucioneve profesionale të MPMS-së.

Neni 2

Institucionet përgjegjëse të MPMS

- 2.1** Sipas Ligjit të aplikushëm në Kosovë, si Institucione përgjegjëse për mbikqyrjen dhe përkujdesjen e fëmijëve të braktisur dhe personave më aftësi të kufizuara mentale, janë Qendrat për Punë Sociale të cilat punojnë dhe veprojnë në të gjitha Komunat e Kosovës.
- 2.2** Divizioni i institucioneve dhe Divizioni i Shërbimeve Sociale të DMS-së, sipas rregullativës juridike mbikëqyrin dhe mbrojnë identitetin dhe intimitetin e fëmijëve të braktisur dhe personave më aftësi të kufizuara mentale, duke përfillur standardet më të larta etike dhe profesionale, në pajtim me Konventat Ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut.

Neni 3

Detyrimet e institucioneve të tjera të përkujdesjes

- 3.1** Qendrat spitalore, Organizatat Qeviritare (OQ), Organizatat Joqeviritare (OJQ), si dhe institucionet e tjera të cilat përkujdesen për foshnjat e braktisura, fëmijët e rritur dhe për personat më aftësi të kufizuara mentale, janë të obliguara që të respektojnë të drejtën e identitetit dhe intimitetit të këtyre personave, duke mos i ekspozuar në mjetet e informimit, me ç'rast do të rrezikoheshin shanset e tyre për, bashkim familjar, vendosje në familje strehuese, adoptuese dhe rehabilitim moral e shpirtëror në komunitetin e tyre.

Neni 4

Procedurat e prezantimit në mjetet e informimit

- 4.1** Për prezantimin dhe ekspozimin e foshnjave të braktisura, fëmijëve të rritur dhe personave më aftësi të kufizuara mentale në mjetet e informimit të cilët ndodhon nën kujdestari, nevojitet pëlqimi paraprak i Kujdestarit Ligjor.
- 4.2** Për grupet e përmenduara të personave të cilët ndodhen më banim në qendrat spitalore, shtëpitë kolektive banuse apo janë nën përkujdesjen rezidenciale, për prezantimin e tyre në media, është i nevojshëm vendimi i Divizionit të institucioneve dhe Divizionit të Shërbimeve Sociale të DMS-së, miratuar nga Zyra për Informim e MPMS-së.

Neni 5

Format dhe kushtet e prezantimit në mjetet e informimit

5.1 Prezantimi dhe paraqitja në media e grupeve të lartpërmendura të personave, mund të bëhet përmes tekstit, fotografisë dhe filmimit, sipas këtyre kushteve :

●**Prezantimi përmes tekstit :**

Nuk lejohet përdorimi i emrave dhe detajeve të tjera private, pa pëlqimin paraprak të kujdestarit ligjor –Divizionit kompetent të MPMS-së.

●**Prezantimi përmes fotografisë:**

Është e lejuar vetëm fotografia nga pas ose në profil, me kusht që personi të jetë i panjohur dhe po qe se është siguruar pëlqimi paraprak nga Kujdestari Ligjor-Divizioni Kompetent i MPMS-së.

●**Prezantimi përmes filmimit :**

Është i lejuar filmimi me kamer për 2-3 sekonda, me kusht që të mos njihet identiteti i personit (përsonave), po qe se është siguruar pëlqimi paraprak i Kujdestarit Ligjor – Divizionit të MSPS-së

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së.

Prishtinë, Nëntor 2003

**Ministri i MPMS-së
Ahmet Isufi**
